



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KORAB R. SEJDIU

Deputet
Poslanik – Representative

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES
ASSEMBLY / SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVES
PRISTINA / PRISTINA - PRISTINA

Prat. No. 06/2739/10 B95
Data / Datum / Date: 28.01.2019

Për / Za / For:	Z. Valdrin Lluka, Ministër Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	28 janar 2019
Referenca / Referenca / Reference:	02/2019
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Ndërmarrjet Publike qëndrore vazhdojnë të raportojnë humbje, që në fakt po rriten me kalimin e kohës dhe janë edhe më të theksuara në vitin 2018. Këto humbje po rrezikojnë qëndrueshmërinë e këtyre ndërmarrjeve, dhe po krijojnë një situatë ku në vend që ato të kontribuojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës, ato po shndërrohen në barrë të vazhdueshme.

PYETJA: Z. Ministër, duke pasë parasysh se ju drejtoni Ministrinë përgjegjëse për mbikqyrjen e këtyre ndërmarrjeve publike, na tregoni ju lutem se çfarë hapa konkret keni ndërmarrë ose do të ndërmerrni që të kërkonin përgjegjësi personale (përfshirë këtu edhe përgjegjësi civile dhe/ose penale) ndaj menaxhmentit të këtyre ndërmarrjeve (drejtorëve të bordit dhe menaxhmentit të lartë) për rikuperimin e humbjeve të shkaktuara në vazhdimësi kryesisht nga keqmenaxhimi, cilët janë ata hapa dhe brenda çfarë afateve kohore?